



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Doretuar Punëdhënësi/Prodator Received/Delivety	31.07.2023	3	viti god veç
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot H Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMESHOK	5448/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.849/2023

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.849/2023 të datës 15.06.2023 të parashtruar nga ankuesja _____ përmes përfaqësuesit me autorizim avokat _____ me adresë banimi Rr. _____, Prishtinë, kundër Vendimit 477 të datës 16.05.2023 të Zëvendësuesit të Drejtorit Ekzekutiv të Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 28.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. **SHFUQIZOHET** Vendimi me numër 477 të datës 16.04.2023 të Zëvendësuesit të Drejtorit Ekzekutiv të Administratës Tatimore të Kosovës.
- II. **OBLIGOHET** Zëvendësuesi të Drejtorit Ekzekutiv të Administratës Tatimore të Kosovës që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë rishqyrtimin e lëndës të parashtruar nga ankuesja _____.
- III. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja _____, e punësuar sipas Akt emërimit të datës 31.12.2022 në pozitën e punës Inspektore e Mesme Tatimore, në Administratën Tatimore të Kosovës, me datën 10.05.2023 ka parashtruar kërkesë për pushim mjekësor pa pagese me kohëzgjatje prej një (1) viti tek Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës, me arsyetim se e njëjta me që _____ e ka të shfrytëzuar të gjithë pushimin mjekësor me pagesë prej njëzet

ditësh (20), dhe për shkak gjendjes shëndetësore të cilën e dëshmon me dokumentacion të mjekut kërkon që ti lejohet pushimi pa pagese prej datës 10.05.2023 deri me datën 14.05.2024.

Zëvendësuesi i Drejtorit Ekzekutiv në Administratën Tatimore të Kosovës me datën 16.05.2023 ka marr vendimin me numër 11/477 me të cilin e ka aprovuar ankesën e ankueses lidhur me pushimin pa pagës vetëm për një muaj respektivisht nga data 15.05.2023 deri me datën 14.06.2023.

Ankuesja e pa kënaqur me vendimin me numër 11/477 të datës 16.05.2023 të Zëvendësuesit të Drejtorit Ekzekutiv në Administratën Tatimore të Kosovës me datën 15.06.2023 përmes përfaqësueset me autorizim avokat N.Rudari ka parashtruar ankesën me numër protokollit 4749/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendim ankimore se vendimi me numër 11/477 i Zëvendësuesit të Drejtorit Ekzekutiv në Administratën Tatimore të Kosovës ka shkelje të parimeve po Rregullave të Shërbimit Civil , si dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 20.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Administratën Tatimore të Kosovës. Ndërsa Këshilli, me datë 23.06.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4749/2023 të datës 15.06.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 13.06.2023; Vendimin me numër 11/477 të datës 16.05.2023; Raportin mjekësor prot.137/23 të datës 12.04.2023 të Ordinancës Psikiatrike Trungu; Raportin mjekësore të datës 13.04.2023; Shenjat mjekësore të datës 08.05.2023; Raportin mjekësore të datës 05.05.2023; Kërkesën me numër Z.Q-11.06.1942 të datës 10.05.2023 të parashtruar nga ankuesja tek organi i punësimit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 20.06.2023; Përgjigjeni në ankesë të datës 23.06.2023; Akt emërimit me numër AE.Nr.398/2022 të datës 31.12.2022; Vendimin me Nr.398/2022 të datës 22.12.2022; Formularin e përshkrimit te detyrave të punës për pozitën e punës "Inspektor i mesëm tatimor".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ekziston baza ligjore qe lënda të kthehet ne *rishqyrtim*, sepse:

Nga administrimi i provave materiale të lëndës rrjedhe së ankuesja është e punësuar sipas Akt emërimit të datës 31.12.2022 në pozitën e punës *Inspektor i Mesëm Tatimore*, në Administratën Tatimore të Kosovës. E njëjta me datë 10.05.2023 përmes mbikëqyrësit të saj gjegjësisht Udhëheqëses së Divizionit per Aktivitete Operative DTR-Prishtina ka parashtruar kërkesë për aprovim të pushimit mjekësor pa pagese tek Udhëheqësja e Divizionit te Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës, me arsyetim se e njëjta meqë e ka shfrytëzuar të gjithë pushimin mjekësore me pagesë prej njëzet ditësh (20), dhe për shkak gjendjes shëndetësore të cilën e dëshmon me dokumentacion të mjekut kërkon që ti lejohet pushimi pa pagese në kohëzgjatje për 1 (një) viti duke filluar nga data 10.05.2023 deri me datën 14.05.2024.



Zëvendësuesi i Drejtorit Ekzekutiv i Administratës Tatimore të Kosovës përmes vendimit me numër protokoll 11/477 të datës 16.05.2023 ka aprovuar ankesën e ankueses lidhur me pushimin pa pagës vetëm për një muaj respektivisht nga data 15.05.2023 deri me datën 14.06.2023.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon se pushimi pa pagese i takon ne baze të nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës. Me tej shton se kërkesa bazohet në trajtim shëndetësor për shkak të gjendjes jo të mirë shëndetësore, kështu që propozon që Këshilli ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe të aprovoj pushimin pa pagës.

Kolegji i Këshillit, lidhur me këtë çështje juridike-administrative, i'u referua Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht nenit 18 paragrafi 4, i cili përcakton se: *"Pushimet e zyrtarëve publikë rregullohen sipas legjislacionit të punës"*, ndërlidhur me këtë e drejta e pushimit të nëpunësve civil është e rregulluar edhe me Rregulloren Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë. Kolegji i Këshillit lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses, ka analizuar dispozitat e nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës me të cilin është theksuar se: *"1. Në bazë të kërkesës së të punësuarit, punëdhënësi mund të lejojë që i punësuarit të mungojë nga puna pa kompensim të pagës. 2. Për kohën e mungesës në punë pa kompensim të pagës nga paragrafi 1. i këtij neni, të punësuarit i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtave të cilat burojnë nga pagesa e detyrueshme e kontributeve nga ana e të punësuarit"*, ndërsa Rregullorja Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, përkatësisht neni 16 ka përcaktuar se: *"1. Në bazë të kërkesës të zyrtarit publik, udhëheqësi më i lartë administrativ mund të lejojë që zyrtarit publik të mungojë nga puna pa kompensim të pagës. 2. Për realizimin e të drejtës për pushim pa pagesë sipas paragrafit 1 të këtij neni, zyrtari publik duhet të paraqet kërkesën e arsyetuar për pushim pa pagesë. 3. Kërkesa duhet të dorëzohet jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë përpara tek mbikëqyrësi i drejtpërdrejt, i cili bashkë me rekomandimin e tij/saj e përcjell për vendimmarrje tek udhëheqësi më i lartë administrativ. Përfundimisht, ky afat nuk aplikohet në rast të pushimit mjekësor pa pagesë. 4. Vendimi i dorëzohet pa vonesë zyrtarit dhe Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore. 5. Për kohën e mungesës në punë pa kompensim të pagës nga paragrafi 1 i këtij neni, zyrtarit publik i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtës për kthim në vendin tij të punës"*, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, referuar dispozitave të cekura si më lartë, konstaton se nëpunësit civil kanë të drejtë që të kërkojnë pushim pa pagesë për shkak të gjendjes shëndetësore dhe trajtimit të nevojshëm shëndetësor, ndërsa është në diskrecion të Udhëheqësit më të lartë të institucionit që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me kërkesën gjithnjë duke u bazuar në dokumentet apo raporte mjekësore të specialisteve të fushës përkatëse respektivisht dokumente bindëse përmes të cilave do të vërtetohet saktë dhe drejtë gjendja shëndetësore e ankueses.

Kolegji i Këshillit në funksion të shqyrtimit të themelësisë së pretendimeve ankimore ka analizuar Vendimin 11/477 të datës 15.05.2023 të Zëvendësuesit të Drejtorit Ekzekutiv në Administratën Tatimore të Kosovës, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se i njëjti bazohet në vërtetim jo të drejtë të gjendjes faktike dhe zbatim jo të drejtë të dispozitave materiale, pasi që sipas vlerësimit të Kolegjit, Zëvendësuesi i Drejtorit Ekzekutiv në Administratën Tatimore të Kosovës, fare nuk ka shqyrtuar pretendimet ankimore, të ankueses lidhur me kërkesën për pushimin pa pagese dhe se i njëjti me

marrjen e vendimit me numër 11-477 nuk ka dhënë asnjë arsytim se pse ankueses nuk i njihet pushimi mjekësorë pa pagesë ashtu siç është kërkuar sipas kërkesës së datës 10.05.2023 por vetëm një muaj, duke mos i shqyrtuar fare provat e lëndës respektivisht raportet mjekësore të lëshuara nga mjeku specialiste i fushës përkatëse.

Andaj, duke qenë së vendimi i atakuar përmban të meta të tillë të cilat pamundësojnë vendosjen meritore lidhur me këtë çështje administrative, Kolegji i Këshillit vlerëson që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek Zëvendësuesi i Drejtorit Ekzekutiv në Administratën Tatimore të Kosovës me detyrimin që i njëjti të rishqyrtoj kërkesën e ankueses, nëse është e nevojshme të kërkoj dokumente apo raporte mjekësore tjera shtesë në mënyrë që të vërtetohet saktë dhe drejtë gjendja shëndetësore e ankueses dhe të nxjerrë vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në mbështetje të fakteve të vërtetuara në mënyrë të plotë dhe drejtë.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit duke bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda më numër A.nr.849/2023

Ilire MEHMETI-SHAQIRI


Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit me autorizim avokat
- Zëvendësuesit te Drejtorit Ekzekutiv ne Administratën Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

